# ALBSIG INVEST

**Albsig Invest sh.a.**
**Fondi i Investimit Albsig Standard**
**Fondi i Pensionit Privat Albsig**
**Fondi i Pensionit Privat Smart Pension**

# PASQYRA PËRMBLEDHËSE

## Contents

1. MESAZH NGA ADMINISTRATORI I PËRGJITHSHËM .......... 5
2. SHOQËRIA ALBSIG INVEST SH.A. .......... 7
2.1. Struktura e aksionerëve të shoqërisë administruese .......... 7
2.2. Objektivat e shoqërisë administruese .......... 7
2.3. Misioni dhe vlerat bazë .......... 7
2.4. Këshilli i administrimit .......... 8
2.5. Kodi i etikës .......... 9
2.6. Transparenca .......... 10
3. PËRGJEGJËSIA SOCIALE .......... 11
3.1. Aktivitete dhe trajnime .......... 11
3.1.1. "Java e parasë" Albsig, dhe Albsig Invest ekspozitë me fëmijët e stafeve .......... 11
3.1.2. Stafi i grave dhe vajzave të Albsig Invest vizitë turistike në Selanik me rastin e festës së 8 Marsit. 12
3.2. Albsig dhe Albsig Invest: Festa e 1 Qershorit me fëmijët e stafit në bregdetin e Durrësit. .......... 13
3.3. Albsig dhe Albsig Invest, promotor në edicionin e 6-të Panairit Ndërkombëtarë të Turizmit!. 14
3.4. Albsig Invest, pjesmarrëse në panairin e punës në Fakultetin e Ekonomisë. .......... 15
3.5. Albsig dhe Albsig Invest, pjesë e panairit të organizuar nga Western Balkans University. .......... 16
4. ECURIA E BORXHIT QEVERITAR DHE E NORMAVE TË INTERESIT GJATË VITIT 2024. .......... 17
4.1. Menaxhimi dhe politikat e investimit .......... 18
4.1. Ligji i ri për fondet private të pensioneve dhe ndikimi i tij në zhvillimin e tregut të pensioneve private në vitin 2024 .......... 19
4.2. Tregu i pensioneve private vijoi rritjen edhe gjatë vitit 2024. .......... 20
4.3. Risitë e pritshme në tregun e fondeve të pensioneve për periudhën në vazhdim. .......... 21
4.4. Pritshmëritë për vitin 2025 .......... 21
5. ECURIA E FONDIT TË INVESTIMIT "ALBSIG STANDARD" .......... 22
5.1. Objektivat dhe politika e investimit .......... 22
5.1.1. Profili i riskut dhe përfitimit .......... 22
5.1.2. Komisionet/tarifat e Fondit .......... 23
5.1.3. Komisione dhe tarifa të tjera të vazhdueshme .......... 23

5.1.4. Komisionet/tarifat të tjera të mbajtura nga Fondi ..... 23
5.1.5. Norma Neto e Kthimit për "Albsig Standard" 2021-2024 ..... 24
6. ECURIA E FONDIT TË PENSIONIT ALBSIG ..... 25
6.1. Politika e Investimit ..... 25
6.1.1. Elementet kryesorë të politikës së investimit: ..... 25
6.1.2. Profili i riskut dhe përfitimit ..... 25
6.1.3. Komisionet/tarifat e Fondit ..... 25
6.1.4. Norma Neto e Kthimit për "Albsig Pension" 2021-2024 ..... 26
7. ECURIA E FONDIT TË PENSIONIT SMART PENSION ..... 27
7.1. Politika e Investimit ..... 27
7.1.1. Elementet kryesorë të politikës së investimit: ..... 27
7.1.2. Profili i riskut dhe përfitimit ..... 27
7.1.3. Komisionet/tarifat e Fondit ..... 27
7.1.4. Norma Neto e Kthimit për "Smart Pension" deri më 31.12.2024 ..... 28
8. PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR ..... 29
RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR ..... 29
Opinioni ..... 29
Baza për opinionin ..... 29
Çështje tjetër ..... 29
8.1. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR ..... 32
8.2. PASQYRA E FITIM OSE HUMBJEVE DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE ..... 33
8.3. PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE ..... 34
8.4. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL ..... 35
9. ALBSIG STANDARD ..... 36
9.1. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR ..... 37
9.2. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR ..... 40
9.3. PASQYRA E FITIM OSE HUMBJEVE DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE ..... 41
9.4. PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE ..... 42
9.5. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË AKTIVET NETO ..... 43
10. ALBSIG PENSION ..... 44
10.1. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR ..... 45

10.2. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR ........ 48
10.3. PASQYRA E FITIM OSE HUMBJEVE DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE ........ 49
10.4. PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE ........ 50
10.5. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË AKTIVET NETO ........ 51
11. SMART PENSION ........ 52
11.1. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR ........ 53
11.2. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR ........ 56
11.3. PASQYRA E FITIM OSE HUMBJEVE DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE ........ 57
11.4. PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE ........ 58

# 1. MESAZH NGA ADMINISTRATORI I PËRGJITHSHËM

*Të nderuar anëtarë dhe investitorë,*

*Është një privilegj i veçantë t'ju drejtohem me mirënjohje të thellë për besimin që na keni dhënë dhe për mbështetjen tuaj të vazhdueshme gjatë këtij rrugëtimi të përbashkët. Kontributi juaj nuk është vetëm një shtyllë e suksesit tonë — është frymëzimi ynë për të ndërtuar më shumë, për të ecur më larg dhe për të qëndruar gjithmonë të përkushtuar ndaj vizionit tonë. Së bashku kemi ndërtuar jo vetëm një themel të fortë, por edhe një aspiratë të përbashkët për të ardhmen, dhe jemi të bindur se hapat që na presin përpara do të jenë edhe më të suksesshëm.*

*Kam kënaqësinë t'ju prezantoj raportin vjetor për vitin financiar 2024 — një vit i karakterizuar nga përparim i qëndrueshëm, inovacion dhe angazhim i palëkundur për të ofruar vlerë të shtuar për investitorët tanë. Gjatë këtij viti, Albsig Invest ka dëshmuar edhe një herë aftësinë për të naviguar me sukses në një mjedis në zhvillim të vazhdueshëm, duke qëndruar besnik ndaj objektivave tona afatgjata.*

*Falë një strategjie të menduar me kujdes dhe një qasjeje të disiplinuar ndaj investimeve, Albsig Invest ka vijuar të ofrojë një performancë të qëndrueshme dhe të sigurt për portofolin e investitorëve tanë. Gjatë vitit 2024, stabiliteti i tregjeve të bonove dhe obligacioneve të shtetit shqiptar ka krijuar mundësi të favorshme për maksimizimin e kthimit, duke na mundësuar të qëndrojmë të përkushtuar ndaj objektivit tonë kryesor: mbrojtjen dhe rritjen e vlerës së investimeve tuaja.*

*Gjatë vitit 2024, kemi konsoliduar më tej standardet e menaxhimit të investimeve dhe kemi thelluar transparencën në çdo hallkë të procesit vendimmarrës, duke u siguruar që çdo veprim i ndërmarrë të reflektojë interesat tuaja afatgjata. Përkushtimi ynë për të ruajtur dhe forcuar besimin tuaj në fondet e pensionit privat, si dhe në portofolin e investimeve të bazuar në bono dhe obligacione, mbetet themel i filozofisë sonë të operimit.*

*Shoqëria Albsig Invest ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë e plotë me ligjin e ri "Për fondet e pensionit privat", i cili hyri në fuqi në nëntor të vitit 2023. Nëpërmjet rishikimit të procedurave të brendshme, përshtatjes së dokumentacionit ligjor dhe trajnimit të stafit, kemi garantuar që veprimtaria jonë të jetë plotësisht në përputhje me kërkesat rregullatore të reja. Ky përkushtim jo vetëm që forcon sigurinë juridike për kontribuuesit tanë, por edhe hap rrugën për të përfituar nga nismat e reja që sjell ligji, si rritja e incentivave fiskale dhe mundësia për krijimin e fondeve të mbyllura të pensionit.*

*Për të bërë një përmbledhje të ecurisë së Fondit të Pensionit Privat Albsig dhe Smart Pension deri në fund të vitit 2024 fondet numërojnë 5385 plane pensioni. Ndërkohë që kthimi i vjetor i fondit të Pensionit Privat*

*Albsig është +4.24%. Fondi i Pensionit Privat Smart Pension ka performuar me një normë kthimi prej +5.55%, duke u renditur si fondi me kthimin më të lartë në treg, rezultat i menaxhimit të kujdesshëm dhe vendimeve të investimit në kohën e duhur.*

*Vlera neto e aseteve të fondeve të pensionit Albsig dhe Smart Pension në fund të muajit dhjetor 2024 arriti në 767 milion lekë, në rritje me 33% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.*

*Fondi i Investimit Albsig Standard, arriti që të mbyllte vitin 2024 me një normë të kënaqëshme kthimi +10.16%. Vlen të theksohet se Vlera Neto e Aseteve (NAV) të fondit në mbyllje të vitit 2024 rezultoi më e lartë se ajo që ishte në fillim të këtij viti me +5.23%.*

*Fondi i Investimit Albsig Standard ka vijuar të tregojë performancë të fortë gjatë vitit 2024, duke ruajtur trendin pozitiv dhe duke arritur një normë kthimi të kënaqshme. Vlera Neto e Aseteve (NAV) e fondit në përfundim të vitit ishte më e lartë se në fillim të periudhës, duke dëshmuar efektivitetin e menaxhimit tonë dhe aftësinë për të kapërcyer sfidat e tregut, në përputhje me objektivat strategjike të Shoqërisë Administruese.*

*Së fundmi, ndërsa kalojmë në vitin e ardhshëm financiar, ne mbetemi të fokusuar në prioritetet tona strategjike. Qëllimi ynë është të konsolidojmë pozicionin tonë si lider tregu, të eksplorojmë mundësi të reja rritjeje dhe të rrisim vazhdimisht vlerën që u ofrojmë investitorëve tanë.*

*Mezi pres të ndaj me ju progresin dhe arritjet tona në vitin e ardhshëm. Faleminderit që jeni pjesë e pandashme e rrugëtimit tonë.*

*Me respekt,*

*Elton Korbi*

**Administrator i Përgjithshëm**

# 2. SHOQËRIA ALBSIG INVEST SH.A.

Albsig Invest Sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, është një shoqëri aksionare, me seli në Rrugën e Barrikadave, Albsig HQ, Kati 8, Tiranë. Albsig Invest Sh.a është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 04.10.2019.

Albsig Invest Sh.a është licensuar Shoqëria Administruese me vendimin e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) nr. 210, datë 22.11.2019 "Për të vepruar si shoqëri administruese e fondeve të pensionit Privat në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit Privat dhe kryerjen e pagesave të pensionit, si dhe për administrimin e aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive" (Licensa nr. 5, datë 22.11.2019 pa afat). Me vendimin e mësipërm AMF miratoi edhe Fondin e Pensionit Privat Albsig.

Me vendimin e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), nr. 255, datë 30.12.2019, u miratua Fondi i Investimit Albsig Standard.

Me vendimin e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), nr. 96, datë 28.04.2022., u miratua Fondi i Pensionit Privat "Smart Pension".

Albsig Invest Sh.a mbikëqyret nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

## 2.1. Struktura e aksionerëve të shoqërisë administruese

Aksioneri i vetëm i shoqërisë është Albsig Jetë Sh.a, i cili zotëron 100% të aksioneve.
Shoqëria Administruese mund të ketë nën administrim një ose disa fonde pensioni dhe një ose disa fonde investimi ne të njëjtën kohë.

Aktualisht Albsig Invest Sh.a ka nën administrim Fondin e Pensionit Privat Albsig, Fondin e Pensionit Privat "Smart Pension" dhe Fondin e Investimit Albsig Standard.

## 2.2. Objektivat e shoqërisë administruese

1. Mbledhja dhe investimi i fondeve të pensionit Privat si dhe kryerja e pagesave të pensionit;
2. Administrimi i fondeve të pensionit Privat dhe aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive.

## 2.3. Misioni dhe vlerat bazë

**Misioni**

Ofrimi i alternativave të përshtatshme për investitorët, ku çdokush të mund të gjejë mënyrën e duhur të investimit, duke u mbështetur tek:

- Informimi dhe edukimi i investitorëve mbi investimin në fonde pensioni dhe fonde investimi;
- Këshillimi i klientëve dhe orientimi i tyre drejt vendimmarrjes së duhur të investimit;

- Menaxhim cilësor të aseteve me qëllim kthime të kënaqshme nga investimi;
- Qeverisje të mirë të korporatës dhe transparencë maksimale për investitorët;
- Krijimi i alternativave të ndryshme investimi me qëllim që çdo investitor të mund të gjejë mundësinë e kërkuar të investimit.

**Vizioni**

Albsig Invest Sh.a synon dhënien e alternativave më të mira dhe të sigurta të investimit në tregun e kapitalit në Shqipëri.

## 2.4. Këshilli i administrimit

Këshilli i Administrimit është organi më i lartë i Shoqërisë Administruese i cili kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare dhe zhvillimin e biznesit të Shoqërisë Administruese. Ai kujdeset që Shoqëria Administruese të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit, miraton politikat financiare, të investimit, Prospektin duke siguruar kështu administrimin e drejtë të Shoqërisë Administruese dhe përgjegjshmërinë kundrejt publikut për veprimet, angazhimin dhe rezultatet e saj. Këshilli përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë si më poshtë:

**Z. Irfan LAMI: Kryetar i Këshillit të Administrimit**

Z. Irfan Lami ka karrierë të gjatë në fushën financiare prej vitit 1995. Z. Lami ka eksperiencë disavjeçare



pranë ISSH në fushën e pensioneve, financës dhe auditimit. Ka eksperiencë mbi 18 vjeçare në menaxhimin financiar dhe drejtues të shoqërive të sigurimeve në Shqipëri dhe Kosovë. Prej vitit 2015 është Drejtor i Departamentit të Financës të Shoqërisë Albsig Sh.a. Z. Lami zotëron diplomë universitare e integruar e nivelit të dytë në Financë nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, që nga viti 1995. Z. Lami ka kryer trajnime të shumta në fushën e menaxhimit financiar dhe të riskut.

**Z. Dritan KASTRATI: Anëtar i Këshillit të Administrimit**

Z. Dritan Kastrati ka një eksperiencë disavjeçare pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, si specialist i



trajtimit të dëmeve, sekretar i Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve/Komisioneve dhe administrimit të praktikave të BSHS. Z. Kastrati prej vitit 2015 është pjesë e Albsig Sh.a si Drejtor i Departamentit të Dëmeve dhe Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm. Z. Kastrati zotëron diplomë master në Administrim Publik nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Z. Kastrati ka kryer trajnime të shumta në fushën e menaxhimit (publik dhe të shoqërive private), të sigurimeve, trajtimit të dëmeve dhe riskut.

**Z. Elvis BEQIRI: Anëtar i Këshillit të Administrimit**

Z. Elvis Beqiri prej vitit 2017 është pjesë e shoqërisë Albsig Sh.a si Drejtor i Sigurimit të Përgjegjësive. Z. Beqiri



ka një eksperiencë 14 vjeçare në fushën bankare në pozicione të ndryshme si Drejtor Departamenti, Drejtues Dege, etj. Z. Beqiri zotëron diplomë master në Administrim Biznesi (MBA) nga Universiteti Polis dhe IPAG Business School, Paris. Z. Beqiri ka kryer trajnime të shumta në fushën e menaxhimit dhe financiare.

**Z. Elton KORBI: Anëtar Ekzekutiv i Këshillit të Administrimit**

Z. Elton Korbi është aktualisht Administrator i Përgjithshëm i Albsig Invest Sh.a. Z. Korbi ka një eksperiencë



mbi 13 vjeçare në sektorin bankar në banka tregtare dhe në Bankën e Shqipërisë, në fushën e auditimit, mbikëqyrjes, kontabilitetit dhe analizës financiare. Z. Korbi zotëron diplomë universitare të integruar të nivelit të dytë në Financë nga Universiteti i Tiranës si dhe diplomë master në Administrim Biznes (MBA) nga Universiteti Epoka. Z. Korbi nga viti 2015 është duke ndjekur studimet për marrjen e certifikatës ACCA (Association of Chartered Certified Accountants). Z. Korbi ka zhvilluar trajnime të shumta në fushën e auditimit, mbikëqyrjes, menaxhimit të riskut, menaxhimit financiar dhe buxhetimit nga institucione prestigjioze si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Deutsche Bundesbank, BaFIN, Banque de France, etj.

**Z. Admir RAMADANI: Anëtar Ekzekutiv i Këshillit të Administrimit**

Z. Admir Ramadani është aktualisht Drejtor i Investimeve dhe Zëvendës Administrator i Përgjithshëm i Albsig



Invest Sh.a. Z. Ramadani ka një eksperiencë 13 vjeçare në sektorin bankar, nga të cilat 5 vjet në fushën e investimeve si dhe 8 vite në fushën e menaxhimit të risqeve. Z. Ramadani zotëron dy diploma në Ekonomiks dhe Matematikë nga Universiteti Amerikan në Bullgari. Z. Ramadani zotëron titullin CFA (Chartered Financial Analyst) që nga Tetor 2012.

## 2.5. Kodi i etikës

Kodi i Etikës është krijuar për të drejtuar etikën personale dhe profesionale të Shoqërisë Administruese. Ai përbëhet nga një set normash dhe rregullash që rregullojnë marrëdhëniet e përditshme të Shoqërisë Administruese. Ai është i zbatueshëm nga të gjithë punonjësit e Shoqërisë Administruese dhe pranë çdo filiali/dege/agjencie të saj. Veç kësaj, personat e tjerë që kryejnë shërbime për Shoqërinë Administruese i nënshtrohen Kodit të Etikës nëpërmjet kontratës apo marrëveshjes. Të gjithë kanë përgjegjësi për të

kontribuar dhe për të ndihmuar në mbajtjen dhe ruajtjen e reputacionit të mirë të Shoqërisë për ndershmëri, përkushtim, korrektesë, paanshmëri dhe integritet.

## 2.6. Transparenca

Transparenca është një nga parimet e shtuara që Albsig Invest e ka ndjekur që nga nisja e aktivitetit si një nga bazat më të rëndësishme për të krijuar urat lidhëse midis shoqërisë dhe klientëve, punonjësve, partnerëve si dhe regullatorëve të saj.

Shoqëria ka qenë dhe do të jetë gjithmonë transparente më të gjithë bashkëpuntorët e saj në dhënien e informacioneve të plota dhe të sakta lidhur me produktet që ofron.

Shoqëria mban të informuar në mënyrë të vazhdueshme klientët e saj në lidhje me ecurinë e fondeve, tarifat që aplikohen si dhe rrisqet që mbart secili fond. Çdo ditë shoqëria përllogarit dhe publikon çmimet dhe Vlerën Neto të Aseteve në faqen e saj të ëeb-it: www.albsiginvest.al.

Gjithashtu çdo klient pajiset me kredencialet e tij personale si Përdorues dhe Fjalëkalim, ku nëpërmjet tyre mund të monitoroj llogarinë e tij personale 24/7. Nëpëmjet platformës Selfcare klienti informohet për balancën e tij, trasaksionet, ecurinë e fondit si dhe mund të gjeneroj certifikatën e pronësisë së kuotave.
Të gjitha publikimet dhe raportet financiare dhe vjetore të Shoqërisë Administruese Albsig Invest dhe të fondeve që shoqëria ka nën administrim janë të disponueshme dhe mund të shfletohen elektronikisht në faqen zyrtare www.albsiginvest.al.

# 3. PËRGJEGJËSIA SOCIALE

## 3.1. Aktivitete dhe trajnime

### 3.1.1. “Java e parasë" Albsig, dhe Albsig Invest ekspozitë me fëmijët e stafeve




“Investo paratë, kultivo të ardhmen” kjo është tematika e ekspozitës për fëmijë, organizuar nga Albsig dhe Albsig Invest me rastin e eventit kushtuar “Javës së parasë”. Ky event kishte fokus perceptimin e fëmijëve pjesëmarrës mbi edukimin financiar. “Java e Parasë” është një aktivitet mbarëbotëror i parasë, e cila ka për qëllim ndërgjegjësimin e brezit të ri për të qenë qytetarë të ardhshëm të përgjegjshëm dhe të aftë për të marrë vendime financiare të mirëmenduara. Të gjitha shoqatat e bankave e sektori i financave përfshirë dhe partnerë të shumtë në mbarë globin, nën koordinimin e Child and Youth Finance International (CYFI) dhe të Federatës Europiane të Bankave (EBF), organizojnë aktivitete të larmishme për t’i përfshirë fëmijët dhe të rinjtë, për të mësuar: si të kujdesen për paratë, si të kursejnë, si të mendojnë financiarisht, si t’i kuptojnë ndryshimet në sistemet ekonomike ku jetojnë, si të fitojnë të ardhura nëpërmjet sipërmarrjes dhe të vendosin bazat për të ardhmen e tyre nëpërmjet kulturës financiare.



Qëllimi i Javës Ndërkombëtare të Parasë është që të fuqizojë gjeneratat e reja dhe të rrisë vetëdijen në lidhje me financat personale, kursimet, burimet e të ardhurave dhe dëshirën për të kursyer. Këtë vit do t’i jepet theks më i veçantë rëndësisë që edukimi financiar ka nga ana e institucioneve, informimi i publikut për rëndësinë e kursimeve dhe edukimit financiar, krijimi i një shoqërie me mirëqenie më të lartë që fëmijët dhe të rinjtë kanë nevojë që të pajisen me informacione të cilat ju shpërbejnë për të marrë vendime më të mira financiare. Ekspozita në Albsig, me pikturat e fëmijëve me tematikë: “investo paratë, kultivo të ardhmen” ishte ideuar e dezajnuar në mënyrë të tillë që të mernin pjesë të gjithë fëmijët e punonjësve të stafeve të Albsig, Albsig Invest. Eventi realizuar për edukimin e femijëve mbi rëndësinë e parasë dhe mirëmenaxhimin e tyre, nxori në pah dhe talentin e të vegjëlve në pikturë.

Ekspozita e pikturës u realizua në sallën e madhe të Albsig ku fëmijët prezantuan punimet e tyre dhe dhanë një mesazh shumë të rëndësishëm mbi menaxhimin e parave në familje dhe rëndësinë e tyre. Por eventi u përmbyll dhe me surpriza për fëmijët. Z. Elton Korbi, Drejtor i Përgjithshëm i Albsig Invest shpërndau certifikata për të gjithë pjesëmarrësit e ekspozitës,

falenderoi prindërit që kanë ndihmuar fëmijët në këtë nismë të rëndësishme dhe premtoi që vitin e ardhshëm do të ketë më shumë aktivitetete të tilla, ku në qendër do të jenë fëmijët.

### 3.1.2. Stafi i grave dhe vajzave të Albsig Invest vizitë turistike në Selanik me rastin e festës së 8 Marsit.



Festa e 8 Marsit ka mbledhur bashkë gjithë stafin e grave dhe vajzave të Albsig, Albsig Jetë, Albsig Invest në një fundjavë turistike në Selanik. I gjithë stafi i grave dhe vajzave të Albsig, Albsig Jetë dhe Albsig Invest janë organizuar pikërisht në fundjavën e festës së 8-marsit dhe kanë realizuar turin e shkurtër. Nisja ka vijuar në mëngjes herët drejt pikës kufitare të Kapshticës. Ndalesat rrugës për pushimin e mëngjesit. Vazhdimi i rrugës drejt kufirit ka qenë shumë harmonik dhe i gëzuar mes këngëve e valleve mes kolektivit. Përfundimi i procedurave kufitare dhe doganore dhe më pas mbërritja në Selanik rreth orës 17.00. Akomodimi nëpër dhoma, darka në hotel dhe koha e lirë për argëtim ka qenë e mbushur plot e për plot me vizita e shëtitje. Eshtë e disata herë që stafi i grave dhe vajzave të Albsig me rastin e festës së 8 Marsit organizon ture të tilla. Ne, në Albsig besojmë se “Klienti është mbret” dhe “stafi është i shenjtë” për këtë edhe shërbimi i mirë vjen nga marrëdhëniet e forta që krijohen tek ekipi ynë, nga përkushtimi i çdo dite për të dhënë më të mirën dhe nga fryma e përfshirjes dhe solidaritetit me klientët.

## 3.2. Albsig dhe Albsig Invest: Festa e 1 Qershorit me fëmijët e stafit në bregdetin e Durrësit.



Albsig dhe Albsig Invest, pjesë e Kastrati Group, organizoi një festë të veçantë për 1-Qershorin në bregdetin e Durrësit, duke mbledhur së bashku fëmijët e stafit të saj për një ditë plot argëtim dhe aktivitete kreative e lojërash të ndryshme për të vegjëlit. Eventi filloi me një ceremoni mirëseardhjeje ku organizatorët e eventit përshëndetën prindërit të pranishëm dhe uruan fëmijët me rastin e festës së 1-Qershorit.

Aktivitetet e ditës përfshinë lojëra të ndryshme në rërë, piktura, gara sportive e lojra argëtuese. Gjithashtu, u organizua një konkurs për ndërtimin e kështjellave prej rëre, ku fëmijët mund të shfaqnin kreativitetin e tyre, në të cilën shfaqën dhe aftësitë e tyre në skulptura dhe piktura. Përveç lojërave dhe aktiviteteve argëtuese u sigurua dhe një zonë e veçantë për ushqim dhe pije për të vegjëlit, ku fëmijët dhe prindërit mundën të shijonin një drekë të shijshme buzë detit. Një ndër momentet kulminante të festës ishte vizita e animatorëve që përformuan numrat e tyre të ideuar pikërisht për atë ditë. Por atmosfera festive kulmoi dhe u plotësua me muzikë dhe kërcime edhe nga prindërit e të vegjëlve.

Festa e 1 Qershorit organizuar nga Albsig dhe Albsig Invest u vlerësua shumë pozitivisht nga të pranishmit dhe u konsiderua si një ndër eventet më të bukura nga të pranishmit duke sjell gëzim dhe buzëqeshje fëmijëve dhe prindërve shoqërues. 1 qershori këtë vit në Albsig erdhi me shumë ngjyra, muzikë e argëtim,

pikërisht për shkak se Dita e Fëmijëve iu kushtua krejtësisht më të dashurve tanë, edhe në ambientet me të dashur për ta siç ishte bregdeti i Durrësit. Stafi i Albsig dhe Albsig Invest bashkë me fëmijët e tyre morën pjesë në festën e organizuar për këtë ditë derisa mesazhi kryesor i prindërve ishte ai për zhvillimin e mëtejshëm të kulturës mbi sigurimet.

## 3.3. Albsig dhe Albsig Invest, promotor në edicionin e 6-të Panairit Ndërkombëtarë të Turizmit!




Muaji prill ka startuar duke hapur siparin e panaireve të shumta në kryeqytet. Një ndër to dhe jo më pak i rëndësishmi ishte Panairi Ndërkombëtarë i Turizmit i cili, ndryshe nga herët e tjera këtë edicion të gjashtë e ka realizuar në qendër të Tiranës në një nga sheshet më të frekuentuara nga konsumatorët, në Sheshin Italia.

Në edicionin e 6-të të Panairit Ndërkombëtar të Turizmit, mori pjesë dhe Albsig, Albsig Invest dhe Tirana International Airport, ku përmes stendave komunikuese, konsumatorët përfituan një prezantim ndryshe nga ana e kompanive pjesmarrëse.

Përveç stendës më fletëpalosje me prezantime të shoqërive u përfitua nga ky rast për të ndarë me pjesëmarrësit një eksperiencë ndryshe. Komunikimi i drejtpërdrejtë me konsumatorët pjesmarrës në këtë eveniment ka qenë një ndër cështjet më të rëndësishme të eventit. Skema e fondit të pensionit privat ka qenë dhe çështja e diskutuar, ku Z. Elton Korbi, Drejtori Ekzekutiv i Albsig Invest, sqaroi avantazhet dhe sigurinë e këtij fondi, si një investim për veten dhe për familjen.

## 3.4. Albsig Invest, pjesmarrëse në panairin e punës në Fakultetin e Ekonomisë.




Albsig Invest gjithmonë do të jetë promotore dhë mbështetëse e studentëve. Këtë herë ka qenë sërish një ndër subjektet pjesëmarrëse në Panairin e Punës organizuar në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, i cili vazhdon të mbetet një traditë shumëvjeçare e suksesshme. Tashmë e kthyer në një traditë të përvitshme Albsig është pjesë e pandashme e eventit të kthyer në një platformë shumë të mirë ndërlidhjeje për studentët me mundësitë e punësimit dhe zhvillimit të karrierës, të ofruara nga mbi 60 kompani të mëdha të pranishme, përfshirë sektorët kryesorë të ekonomisë si konsulenca, bankat, sigurimet, prodhimi, teknologjia, telekomunikacioni, etj.

Stenda e Albsig spikati me numrin e madh të vizitorëve. Albsig numëron shumë vite që është bërë pjesë mbështetëse dhe promotore e eventeve të ndryshme të zhvilluara nga fakulteti Ekonomisë. Panairi i Punës i Fakultetit të Ekonomisë, Universitetit të Tiranës, është një urë lidhëse për të gjithë ata që kërkojnë të ndërtojnë lidhje të reja, të zgjerojnë rrjetin e tyre profesional dhe të shfrytëzojnë mundësitë për të arritur sukses në karrierë. Kjo traditë vazhdon të jetë një shembull i bashkëpunimit dhe inovacionit në rrugën drejt një të ardhmeje më të ndritshme ekonomike dhe profesionale, si për studentët ashtu edhe për kompanitë pjesëmarrëse dhe dhanë një mesazh shumë të rëndësishëm mbi menaxhimin e parave në familje dhe rëndësinë e tyre. Por eventi u përmbyll dhe me surpriza për fëmijët. Z. Elton Korbi, Drejtor i Përgjithshëm i Albsig Invest shpërndau certifikata për të gjithë pjesëmarrësit e ekspozitës, falenderoi prindërit që kanë ndihmuar fëmijët në këtë nismë të rëndësishme dhe premtoi që vitin e ardhshëm do të ketë më shumë aktivitetete të tilla, ku në qendër do të jenë fëmijët.

## 3.5. Albsig dhe Albsig Invest, pjesë e panairit të organizuar nga Western Balkans University.




Western Balkans University, në bashkëpunim me Dhomën Britanike të Tregtisë në Shqipëri, organizoi Panairin e Karrierës, që solli së bashku mbi 60 biznese dhe institucione për t'u ofruar studentëve një pasqyrë reale të botës së punës. Albsig dhe Albsig Invest, pjesë e Kastrati Group, ishte krenare të ishte pjesë e këtij aktiviteti, duke sjellë në stendën e saj eksperiencën dhe energjinë e një ekipi të përkushtuar.

Studentët e WBU u treguan mjaft të interesuar për mundësitë e internshipeve dhe bashkëbiseduan me ekspertët tanë për të kuptuar më mirë si mund të integrohen në tregun e punës. Për shumë prej tyre, ky panair ishte një hap i parë i rëndësishëm drejt një karriere të suksesshme. Albsig, si gjithmonë, mbështet iniciativat që nxisin zhvillimin profesional të të rinjve dhe i orienton ata drejt mundësive konkrete për praktikë dhe punësim.





## 3.6. Albsig Invest dhe Qendra për Edukim Kulinar: Një Ditë Gatimi Plot Dashuri për Fëmijët në Nevojë.




Albsig dhe Albsig Invest organizoi një aktivitet të veçantë bamirësie në bashkëpunim me Qendrën për Edukim Kulinar (QEK), me qëllim mbështetjen e fëmijëve në nevojë përmes gatimit të ushqimeve të shëndetshme dhe të shijshme për të gjitha moshat. Ky aktivitet u mirëprit nga stafi i Albsig dhe Albsig Invest , ku morën pjesë 11 punonjës të cilët jo vetëm kontribuan me kohën dhe energjinë e tyre pozitive, por edhe krijuan një atmosferë të ngrohtë dhe të gëzueshme në ambientet e kuzhinës.
Qëllimi i këtij aktiviteti ishte ofrimi i vakteve të shëndetshme për fëmijët që ndodhen në situata të vështira ekonomike dhe sociale. Gatimi i përbashkët u kthye në një eksperiencë bashkëpunimi dhe kreativiteti, ku punonjësit e Albsig dhe Albsig Invest jo vetëm treguan aftësitë e tyre në kuzhinë, por u angazhuan për të ofruar ushqime të shijshme dhe të servirura me përkujdesje.
Një nga aspektet më të bukura të këtij aktiviteti ishte ndërveprimi i stafit të Albsig me profesionistët e kulinarisë, duke mësuar teknika të reja gatimi dhe duke përfituar nga përvoja edukative që ofron kjo qendër. Ky event ishte një mundësi për të kombinuar përgjegjësinë sociale të Albsig me ndihmën direkte për komunitetin, duke rritur frymën e bashkëpunimit brenda ekipit.
Për Albsig, përgjegjësia sociale nuk është thjesht një detyrim korporativ, por një mision i rrënjosur thellë në vlerat e kompanisë. Aktiviteti i fundit, organizuar në bashkëpunim me QEK, ishte një iniciativë për të ofruar vakte të ngrohta për fëmijët në nevojë dhe për të krijuar një ndjenjë të veçantë kënaqësie për punonjësit që morën pjesë.
Ky aktivitet është pjesë e strategjisë së përgjegjësisë sociale që Albsig ka ndërmarrë për të bërë ndryshime pozitive në shoqëri. Përmes partneriteteve dhe nismave të ndryshme që mbështesin grupet më të ndjeshme, Albsig tregon se mbështetja e komunitetit është një prioritet i rëndësishëm.Duke vendosur një standard të lartë për Përgjegjësinë Sociale në sektorin e sigurimeve, Albsig Invest synon të vazhdojë me organizime të tjera bamirësie dhe sociale, për të ndihmuar jo vetëm fëmijët, por edhe komunitetet e prekura nga varfëria apo sfida të tjera sociale. Me përkushtim dhe angazhim, Albsig vazhdon të kontribuojë në përmirësimin e jetës së njerëzve në nevojë.

# 4. ECURIA E BORXHIT QEVERITAR DHE E NORMAVE TË INTERESIT GJATË VITIT 2024.

Banka e Shqipërisë Ul Normën Bazë dhe Normat e Interesit në 2024: Një Pasqyrë e Ecurisë Ekonomike dhe Inflacionit

Në vitin 2024, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një seri hapash të rëndësishëm për të stimuluar ekonominë e vendit dhe për të mbajtur inflacionin nën kontroll. Pjesë e këtyre masave ka qenë ulja e normës bazë të interesit, si dhe një rënie e ndjeshme e normave të interesit për obligacionet e qeverisë shqiptare.

**Uljet e Normës Bazë të Interesit:**
Në korrik 2024, Banka e Shqipërisë ul normën bazë të interesit nga 3.25% në 3%, një hap që synonte të ulte koston e kreditimit për individët dhe bizneset, duke stimuluar kështu aktivitetin ekonomik. Në nëntor të po këtij viti, banka ka vazhduar këtë tendencë me një tjetër ulje, duke e reduktuar normën bazë në 2.75%. Këto ulje të normës së interesit janë pjesë e përpjekjeve të bankës për të balancuar rritjen ekonomike dhe kontrollin e inflacionit.

**Inflacioni dhe Efektet në Ekonomi:**
Një nga zhvillimet më të rëndësishme në vitin 2024 është rënia e inflacionit në nivelin 2.21% në dhjetor, një ulje e ndjeshme në krahasim me nivelet e larta të vitit të kaluar. Ky rezultat tregon përpjekjet e suksesshme të Bankës së Shqipërisë për të ruajtur stabilitetin e çmimeve, duke krijuar një mjedis më të favorshëm për konsumatorët dhe investitorët.

**Normat e Interesit për Obligacionet e Qeverisë:**
Një tjetër pasojë e politikave të uljes së normës bazë ka qenë rënia e normave të interesit për obligacionet e qeverisë shqiptare. Këto ndryshime janë reflektuar në të gjitha maturimet e obligacioneve:

**Bono 12 mujore** ka pasur një ulje të ndjeshme, duke kaluar nga 3.4% në fillim të vitit në 2.76% në fund të vitit.
**Obligacioni 2-vjeçar** ka pësuar një rënie nga 4.23% në 3.38%.
**Obligacionet 3 dhe 5-vjeçare** kanë pasur ulje të konsiderueshme: nga 4.89% dhe 5.58%, në 3.5% dhe 3.96%, përkatësisht.
**Obligacionet 7-vjeçare** janë ulur nga 5.96% në 4.85%, ndërsa Obligacionet 10-vjeçare nga 6.44% në 5.93%.
**Obligacioni 15-vjeçar** ka pësuar gjithashtu një ulje, duke rënë nga 7.89% në 6.41%.

Këto ulje të normave të interesit për obligacionet janë një pasqyrë e përgjigjes së politikave monetare të Bankës së Shqipërisë, të cilat synojnë të rrisin likuiditetin në treg dhe të inkurajojnë investimet në tregun financiar të brendshëm.

Viti 2024 ka qenë një vit i rëndësishëm për politikën monetare të Bankës së Shqipërisë. Uljet e normës bazë dhe të normave të interesit për obligacionet e qeverisë janë tregues të një strategjie të kujdesshme për të mbajtur ekonominë të qëndrueshme dhe për të kontrolluar inflacionin. Me inflacionin në nivele të ulëta dhe normat e interesit të ulura, Shqipëria ka krijuar një mjedis të favorshëm për investitorët dhe konsumatorët, duke ofruar mundësi për rritje të aktivitetit ekonomik në të ardhmen.

## 4.1. Menaxhimi dhe politikat e investimit

Albsig Invest ka ndjekur me shumë kujdes politikat monetare dhe zhvillimet në tregun e interesave gjatë vitit 2024, duke u pozicionuar në mënyrë të favorshme për të përfituar nga rënia e normave të interesit. Kjo ka rezultuar në një performancë shumë pozitive, me një normë kthimi prej 10.16% për vitin 2024, e cila tregon suksesin e menaxhimit të investimeve dhe strategjisë fleksibël të fondit.

Përgjatë vitit, normat e interesit, sipas politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, kishin arritur kulmin e tyre, dhe pritshmëritë ishin që ato do të vazhdonin të uleshin. Albsig Invest, duke pasur një vështrim të qartë mbi zhvillimet ekonomike dhe tregun financiar, mori masa të shpejta dhe të menduara për të optimizuar strategjitë e saj të investimit, si për fondin e investimeve ashtu edhe për fondet e pensioneve.

Këto masa përfshinin rritjen e investimeve në instrumente financiare që do të përfitonin më shumë nga ulja e normave të interesit, duke shfrytëzuar mundësitë që krijoheshin në treg. Kjo mundësoi që Albsig Invest të maksimizonte kthimet për investitorët, duke siguruar një pozicion shumë të favorshëm në një vit të vështirë për ekonominë globale.

Në këtë kontekst, strategjia e Albsig Invest ka qenë thelbësore për të kapitalizuar ndryshimet e politikës monetare dhe për të ofruar rezultate të qëndrueshme dhe fitimprurëse, duke e vendosur atë si një lider në menaxhimin e fondeve dhe pensioneve në Shqipëri.

## 4.1. Ligji i ri për fondet private të pensioneve dhe ndikimi i tij në zhvillimin e tregut të pensioneve private në vitin 2024

Ligji i ri "Për fondet e pensionit privat", i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe i hyrë në fuqi më 6 nëntor 2023, ka sjellë përmirësime të rëndësishme në kuadrin ligjor të sektorit të pensioneve private. Ky ligj përfaqëson një përafrim të avancuar me Direktivën Europiane IORP II, duke rregulluar në mënyrë më të qartë dhe të plotë aspektet që ligji i mëparshëm nuk i trajtonte me efikasitet.

Një nga ndryshimet më domethënëse është trajtimi fiskal i kontributeve dhe përfitimeve nga fondet e pensionit privat. Ndryshe nga ligji aktual, ku kontributet dhe interesi gjatë fazës së akumulimit përjashtohen nga tatimi, por pagesat e pensionit tatohen në tërësi, ligji i ri parashikon që kontributet dhe interesi të jenë të përjashtuara nga tatimi edhe në momentin e tërheqjes, në rast se pagesat realizohen në formën e pensionit (këste mujore) për një periudhë më të gjatë se dy vjet. Në këtë rast tatimi do të aplikohet vetëm mbi interesin e akumuluar gjatë periudhës, duke krijuar një stimul fiskal të rëndësishëm për pjesëmarrjen në skemën private të pensioneve.

Ligji synon gjithashtu të mbrojë interesat e anëtarëve të fondeve të pensionit dhe të nxisë pjesëmarrjen në këtë sistem, duke krijuar një ambient më të sigurt dhe tërheqës për kontribuuesit aktualë dhe potencialë.

Një tjetër risinë e rëndësishme e ligjit është parashikimi i fondeve private me pjesëmarrje të mbyllur, të cilat mund të krijohen nga një ose disa punëdhënës, sindikata apo bashkime punëdhënësish, si një formë e re organizimi që ofron fleksibilitet dhe përshtatje me nevojat specifike të grupeve të punonjësve.

Ligji gjithashtu vendos rregulla më të qarta për aktivitetin promovues dhe marketingun e fondeve të pensionit privat, me qëllim rritjen e njohjes dhe pjesëmarrjes së individëve dhe punëdhënësve në këto skema.

Përveç kësaj, ligji krijon kushtet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare sipas standardeve të Direktivës Europiane, duke i përgatitur fondet private shqiptare për sfidat dhe mundësitë e integrimit të ardhshëm të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Për suksesin e këtij ligji, është thelbësore që jo vetëm Shoqëritë Administruese, por edhe institucionet shtetërore si Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë të angazhohen aktivisht në promovimin e mundësive të reja që ofron ligji për pjesëmarrjen në fondet e pensionit privat.

Në periudhën afatmesme, kjo iniciativë pritet të jetë një mbështetje e fortë për skemën shtetërore të pensioneve, duke forcuar sistemin pensional dhe duke zgjeruar mundësitë për sigurimin e një pensioni të qëndrueshëm dhe të qëndrueshëm financiarisht për qytetarët shqiptarë.

## 4.2. Tregu i pensioneve private vijoi rritjen edhe gjatë vitit 2024.

Gjatë vitit 2024, tregu i fondeve të pensioneve private në Shqipëri vijoi të zhvillohet me ritme të qëndrueshme dhe pozitive. Sipas të dhënave të publikuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), në këtë treg operuan shtatë fonde pensioni, përfshirë fonde me pjesëmarrje të hapur dhe të mbyllur.

Në fund të vitit, vlera e aseteve neto të fondeve të pensioneve private arriti në 12,870.8 milionë lekë (rreth 82.61 milionë euro), duke shënuar një rritje impresive prej 16.84% ose 1,855 milionë lekë krahasuar me 31 dhjetor 2023. Ky progres reflekton besimin dhe interesin në rritje të qytetarëve shqiptarë për pensionet private si një element kyç i planifikimit të qëndrueshëm financiar në afatgjatë.

Një tjetër tregues pozitiv është rritja e numrit të anëtarëve. Më 31 dhjetor 2024, fondet e pensioneve private numëronin gjithsej 44,926 anëtarë, me një rritje prej 15.71% krahasuar me vitin e kaluar. Vetëm gjatë këtij viti, fondeve iu shtuan 6,098 kontribuues të rinj, çka tregon një ndërgjegjësim në rritje të individëve mbi rëndësinë e sigurimit të të ardhmes së tyre financiare përmes pjesëmarrjes në skema të pensioneve private.

Rritja e vazhdueshme e aktiveve dhe numrit të pjesëmarrësve përbën një sinjal të fortë për qëndrueshmërinë dhe potencialin e mëtejshëm të këtij segmenti financiar. Ajo pasqyron gjithashtu efektivitetin e politikave mbikëqyrëse të AMF-së dhe të reformave ligjore që kanë krijuar kushte më të favorshme për pjesëmarrje dhe investim.

Megjithatë, niveli i depërtimit të pensioneve private në shoqëri vijon të mbetet i ulët. Më pak se 3% e të punësuarve aktualisht kontribuojnë në një fond pensionesh privat, ndërsa vlera mesatare e aseteve për anëtar mbetet modeste. Tregu i pensioneve private mbetet segmenti më i vogël i sistemit financiar në Shqipëri, duke nënvizuar nevojën për politika dhe stimuj shtesë për zgjerimin e pjesëmarrjes.

Në këtë kuadër, një zhvillim i rëndësishëm ka qenë hyrja në fuqi, në nëntor 2023, e ligjit të ri “Për fondet e pensionit privat”. Ky ligj synon të rrisë atraktivitetin e skemave private përmes incentivave fiskale të përmirësuara. Ndër të tjera, ai parashikon që kufiri maksimal mujor për përjashtim tatimor të barazohet me pagën minimale të miratuar (aktualisht 40,000 lekë), si dhe që pensionet të mos tatohen për kontributet, por vetëm për kthimet nga investimi, me kusht që tërheqja të bëhet në pagesa mujore për një periudhë jo më të shkurtër se dy vite.

Në përfundim, viti 2024 ka shënuar një fazë konsolidimi dhe progresi të rëndësishëm për tregun e pensioneve private në Shqipëri. Rritja e vazhdueshme e treguesve financiarë, përmirësimi i kuadrit ligjor dhe ndërgjegjësimi në rritje i qytetarëve tregojnë se fondet e pensioneve po shndërrohen gradualisht në një alternativë të besueshme dhe të qëndrueshme për sigurimin e një pleqërie të qetë dhe të planifikuar.

## 4.3. Risitë e pritshme në tregun e fondeve të pensioneve për periudhën në vazhdim.

Tregu i fondeve të pensioneve private në Shqipëri po përjeton një fazë dinamike zhvillimi, ku risitë dhe ndryshimet ligjore dhe operative po krijojnë mundësi të reja për përmirësimin e shërbimeve dhe rritjen e pjesëmarrjes së individëve. Për periudhën në vazhdim, priten disa zhvillime kyçe që do të ndikojnë pozitivisht në këtë sektor.

Një nga risitë më të rëndësishme është integrimi gradual i fondeve të pensioneve me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian, veçanërisht pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri "Për fondet e pensionit privat" në nëntor 2023. Ky ligj përfshin dispozita që lehtësojnë ofrimin e shërbimeve ndërkufitare dhe harmonizimin me Direktivën Europiane IORP II, duke mundësuar që fondet të operojnë më lehtë në nivel rajonal dhe të ofrojnë produkte më konkurruese dhe fleksibile.

Gjithashtu, parashikohet që tregu të shohë një rritje të numrit të fondeve me pjesëmarrje të mbyllur. Këto fonde, që mund të krijohen nga grupe punëdhënësish, sindikata apo bashkime të punëdhënësve, do të ofrojnë skema më të personalizuara dhe të përshtatura për nevojat specifike të grupeve të punonjësve, duke rritur pjesëmarrjen dhe përfitimet për anëtarët.

Në aspektin fiskal, incentiva të reja dhe më të fuqishme pritet të stimullojnë më tej pjesëmarrjen në fondet e pensioneve private, duke e bërë skemën private të pensioneve një opsion më tërheqës dhe financiarisht më të favorshëm për qytetarët dhe punëdhënësit.

Nga ana teknologjike, do të ketë avancime në digitalizimin e shërbimeve të pensioneve, duke përmirësuar aksesin dhe transparencën për anëtarët. Platforma online dhe aplikacionet mobile do të mundësojnë menaxhim më të lehtë të planeve të pensionit dhe komunikim më efektiv me fondet.

Në përmbledhje, periudha në vazhdim do të karakterizohet nga zhvillime që synojnë forcimin e qëndrueshmërisë, rritjen e besimit dhe pjesëmarrjes së publikut në fondet e pensioneve, si dhe ofrimin e shërbimeve më të avancuara dhe fleksibile që i përshtaten nevojave të një tregu në ndryshim e sipër.

## 4.4. Pritshmëritë për vitin 2025

Lëvizja e normave të interesit gjatë tremujorit të parë dhe të dytë të vitit 2025 do të ndikohet nga dy faktorë kryesorë: nga tendencat sezonale dhe nga vendimet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.

Historikisht, kjo periudhë e vitit karakterizohet nga ulje ciklike të normave të interesit, për shkak të rënies së kërkesës për likuiditet pas sezonit festiv dhe qetësimit të tregjeve. Megjithatë, pritshmëritë janë gjithashtu të lidhura ngushtë me vendimet që do të marrë Banka e Shqipërisë në lidhje me normën bazë të interesit, në varësi të zhvillimeve ekonomike dhe inflacionit.

Aktualisht, inflacioni ka qëndruar nën objektivin prej 3% gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024, çka do t'i lejonte bankës qendrore të konsiderojë një lehtësim të mëtejshëm të politikës monetare. Por, në rast se presionet inflacioniste globale intensifikohen, atëherë mund të shfaqet nevoja për rishikim në rritje të normës bazë për të ruajtur stabilitetin e çmimeve.

Pra, drejtimi që do të marrin normat e interesit në fillim të vitit 2025 do të varet nga balanca mes tendencave sezonale lehtësuese dhe rreziqeve të jashtme që lidhen me inflacionin dhe tregjet globale.

# 5. ECURIA E FONDIT TË INVESTIMIT "ALBSIG STANDARD"

Fondi Investimit Albsig Standard është një Sipërmarrje Investimesh Kolektive (SIK), e veçantë me pjesëmarrje të hapur e cila administrohet nga shoqëria administruese "Albsig Invest sh.a."

## 5.1. Objektivat dhe politika e investimit

Albsig Standard investon kryesisht në obligacione dhe bono të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të emetuara në Lekë, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat tregtare në Shqipëri. Objektivi i investimit është rritje e të ardhurave duke ruajtur principalin dhe likuiditetin. Fondi për të arritur diversifikimin mund të investojë deri në 10% në tituj borxhi të transferueshëm të kompanive apo njësive vendore me seli në Republikën e Shqipërisë por këto investime nuk ndikojnë mbi tolerancën e ulët për rrezik që ka Fondi.

Investitori mund të shlyej të gjithë kuotat apo një pjesë të tyre sipas kërkesës në çdo kohë mbas investimit fillestar pa prishur normën e kthimit të realizuar deri në atë periudhë.

Fondi i Investimit Albsig Standard nuk mbështet në një tregues referencë (benchmark) të caktuar.
Të ardhurat nga Fondi ri-investohen dhe nuk shpërndahen. Kostot e transaksioneve të portofolit nuk kanë një ndikim material mbi performancën e fondit. Rekomandohet që afati për investimin në Fond të jetë të paktën 2 vjet.

Performanca e fondit ndikohet kryesisht nga ecuria e normave të interesit të letrave të borxhit të Republikës së Shqipërisë. Fondi investon vetëm në klasat e aseteve të përmendura më sipër dhe nuk lejon zgjedhje të lira në lidhje me investime të veçanta të lejueshme.

### 5.1.1. Profili i riskut dhe përfitimit

**Risk i ulët** | **Risk i lartë**
**Përfitime zakonisht të ulëta** | **Përfitime zakonisht të larta**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |

Fondi i Investimit Albsig Standard ka një indikator risku në nivelin 3, pra të ulët, por nuk do të thotë që investimi është pa rrezik. Kategoria 3 përbën një risk sintetik i cili llogaritet duke u bazuar në luhatshmërinë e Fondit. Luhatshmëria e lartë ka një indikator risku më të lartë dhe një luhatshmëri më e ulët ka një indikator risku më të ulët. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nëpërmjet një rregullore specifike përcakton lidhjen midis luhatshmërisë së fondit dhe indikatorit të riskut sintetik. Për shkak se kjo kategori sintetike përdor të dhënat historike, treguesi sintetik mund të ndryshojë në të ardhmen por ky ndryshim

parashikohet të jetë i rrallë. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit sintetik mund të mos jenë të dhëna relevante për profilin e ardhshëm të riskut të Fondit të Investimit Albsig Standard.

Risqet që nuk janë të përmbledhura në kategorinë e riskut sintetike janë: risku i kreditit, risku likuiditetit, risku operacional, risku i palës tjetër. Risku i kreditit mund të ndodh kur emetuesi i ndonjë obligacioni apo bono nuk është i gatshëm të paguaj interesin apo principalin në kohë.

Obligacionet dhe bonot zotërojnënjë spektër gradash që përfaqësojnë riskun e kredisë. Fondi do investoi kryesisht në letra borxhi të Republikës së Shqipërisë dhe është lidhur ngushtë me aftësitë paguese të Shtetit Shqiptar. Risku i likuiditetit lidhet me faktin se obligacionet dhe bonot e Republikës së Shqipërisë nuk mund të tregtohen në çdo kohë apo do tregtohen me çmime jo të favorshme. Risku Operacional lind nga gabime të sistemeve ose gabime njerëzore të shoqërisë administruese. Risku i palës tjetër ndodh kur një pagesë të mos kryhet apo të kryhet me vonesë në një sistem transfertash për shkak të moszbatimit të kushteve të paracaktuara.

### 5.1.2. Komisionet/tarifat e Fondit

Komisionet/tarifat që investitori paguan përdoren për të shlyer kostot e administrimit të Fondit të Investimit Albsig Standard. Këto komisione ulin rritjen e mundshme të investimit. Komisionet dhe tarifat mund të jenë subjekt ndryshimi.

- Komisione/tarifa të njëhershme përpara ose pas investimit
- Komisioni/tarifa e hyrjes - 0 %
- Komisioni/tarifa i/e shlyerje - 0 %
- Komisionet/tarifat të vazhdueshme që mbahen nga Fondi gjatë periudhës së një viti
- Komisioni/tarifa vjetore e administrimit të Fondit – deri në 1%

### 5.1.3. Komisione dhe tarifa të tjera të vazhdueshme

- Tarifa e auditimit vjetor të fondit është sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese.
- Tarifa e depozitarit - 0.17% në vit e VNA
- Tarifa e AMF - 0.05% në vit e vlerës së përgjithshme të aseteve
- Tarifa e kostos së vazhdueshme, në një vit financiar nuk do të tejkalojnë maksimumin prej 1.5%
- (një pikë pesë përqind) të vlerës neto të aseteve të Fondit.

### 5.1.4. Komisionet/tarifat të tjera të mbajtura nga Fondi

- Kosto të transaksioneve për investimin e aseteve të fondit - sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese.
- Kostot e transaksioneve nuk do të përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por i mbahen Fondit.

Për më shumë informacion për komisionet, ju lutemi shihni faqet përkatëse të prospektit të Fondit, të cilin mund ta gjeni edhe në faqen e internetit www.albsiginvest.al.

Portofoli i Fondit të Investimeve Albsig Standard më 31 dhjetor 2024, në përputhje me Politikën e Investimit, përbëhet kryesisht nga obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë.




### 5.1.5. Norma Neto e Kthimit për "Albsig Standard" 2021-2024



Fondi i Investimit Albsig Standard për periudhën 01.01.2024-31.12.2024 ka rezultuar me një normë kthimi prej 10.16%. Tarifa e administrimit zbritet përpara llogaritjes së normës së kthimit. Performanca e mëparshme apo performanca afatshkurtër nuk duhet përdorur si udhëzuese e performancës në të ardhmen.

# 6. ECURIA E FONDIT TË PENSIONIT ALBSIG

Fondi i adresohet klientëve konservator me tolerancë të ulët rreziku. Fondi investon vetëm në obligacione afatgjata të Republikës së Shqipërisë. Tradicionalisht obligacionet qeveritare janë aseti me rrezikun më të ulët ndër asetet e tjera në tregun e kapitaleve.

## 6.1. Politika e Investimit

Fondi do të investojë kryesisht në obligacione afatgjata të Shtetit Shqiptar. Element i rëndësishëm që shoqëron investimin për pension është kohëzgjatja e gjatë.

### 6.1.1. Elementet kryesorë të politikës së investimit:

**Objektivi:** Optimizimi i normës së kthimit duke ruajtur principalin;

**Toleranca për Rrezik:** E ulët;

**Horizonti i Investimit:** Afatgjatë (10-30 vjet);

**Likuiditeti:** I ulët.

**Strategjia e Investimit:** Fondi do të ndjekë një strategji të investimit në asete afatgjata. Fondi gjithashtu ka kërkesa të ulta për likuiditet duke konsideruar kohëzgjatjen e qëndrimit të gjatë në fond dhe prurjet periodike nga pagesat automatike të skemave profesionale dhe individuale.

### 6.1.2. Profili i riskut dhe përfitimit

**Risk i ulët** — **Risk i lartë**

**Përfitime zakonisht të ulëta** — **Përfitime zakonisht të larta**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |

### 6.1.3. Komisionet/tarifat e Fondit

Shoqëria Administruese do të aplikojë tarifat e mëposhtme:

Tarifa e administrimit të Fondit do të jetë 2.5% (dy pikë pesë përqind) në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit. Vlera neto e aseteve përbëhet nga vlera e përgjithshme e aseteve e zvogëluar nga zbritja e detyrimeve dhe tarifave deri në datën e vlerësimit;

Në rastin e transferimit të aseteve nga Anëtari në një Fond tjetër të menaxhuar nga një Shoqëri tjetër Administruese, tarifa që do të aplikohet do të jetë 0.5% (zero pikë pesë përqind) e shumës së transferuar. Portofoli i Fondit të Pensioneve Privat Albsig më 31 dhjetor 2024, në përputhje me Politikën e Investimit, përbëhet kryesisht nga bono dhe obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë.




### 6.1.4. Norma Neto e Kthimit për "Albsig Pension" 2021-2024



# 7. ECURIA E FONDIT TË PENSIONIT SMART PENSION

Fondi i adresohet klientëve konservator me tolerancë të ulët rreziku. Fondi investon vetëm në obligacione afatgjata të Republikës së Shqipërisë. Tradicionalisht obligacionet qeveritare janë aseti me rrezikun më të ulët ndër asetet e tjera në tregun e kapitaleve.

## 7.1. Politika e Investimit

Fondi do të investojë kryesisht në obligacione afatgjata të Shtetit Shqiptar. Element i rëndësishëm që shoqëron investimin për pension është kohëzgjatja e gjatë.

### 7.1.1. Elementet kryesorë të politikës së investimit:

**Objektivi:** Optimizimi i normës së kthimit duke ruajtur principalin;
**Toleranca për Rrezik:** E ulët;
**Horizonti i Investimit:** Afatgjatë (10-30 vjet);
**Likuiditeti:** I ulët.
**Strategjia e Investimit:** Fondi do të ndjekë një strategji të investimit në asete afatgjata. Fondi gjithashtu ka kërkesa të ulta për likuiditet duke konsideruar kohëzgjatjen e qëndrimit të gjatë në fond dhe prurjet periodike nga pagesat automatike të skemave profesionale dhe individuale.

### 7.1.2. Profili i riskut dhe përfitimit

**Risk i ulët** — **Risk i lartë**
**Përfitime zakonisht të ulëta** — **Përfitime zakonisht të larta**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |

### 7.1.3. Komisionet/tarifat e Fondit

Shoqëria Administruese do të aplikojë tarifat e mëposhtme:
Tarifa e administrimit të Fondit do të jetë 1.5% (një pikë pesë përqind) në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit. Vlera neto e aseteve përbëhet nga vlera e përgjithshme e aseteve e zvogëluar nga zbritja e detyrimeve dhe tarifave deri në datën e vlerësimit;

Në rastin e transferimit të aseteve nga Anëtari në një Fond tjetër të menaxhuar nga një Shoqëri tjetër Administruese, tarifa që do të aplikohet do të jetë 0.5% (zero pikë pesë përqind) e shumës së transferuar.
Portofoli i Fondit të Pensioneve Privat “Smart Pension” më 31 dhjetor 2024, në përputhje me Politikën e Investimit, përbëhet kryesisht nga bono dhe obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë.




### 7.1.4. Norma Neto e Kthimit për "Smart Pension" deri më 31.12.2024.



# 8. PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

RSM

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin e ALBSIG INVEST sha Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive.

### Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të ALBSIG INVEST sha Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2024, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilisteve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Çështje tjetër

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 janë audituar një auditues tjetër i cili ka shprehur një opinion pa rezerva mbi ato pasqyra financiare në 29 mars 2024.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur

përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.
Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.
Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.
Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.
Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në

evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

### Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione përgatitur në përputhje me Ligjin Nr. 25/2018 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera të Shoqërisë për vitin 2024 pritet të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe te vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale. Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.

Elona Bisha

Auditues Ligjor

RSM Albania

Tiranë, 28 mars 2025

## 8.1. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

**ALBSIG INVEST SHA**
**Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Pasqyra e Pozicionit Financiar
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

| | Shënime | 31 dhjetor 2024 | 31 dhjetor 2023 |
|---|---|---|---|
| **Aktivet** | | | |
| Paraja dhe ekuivalentë të saj | 6 | 2,841,525 | 1,367,911 |
| Të arkëtueshme nga Fondet | 7 | 1,771,685 | 1,264,197 |
| Të arkëtueshme të tjera | 8 | - | 3,087,786 |
| Shpenzime të parapaguara | 9 | 673,660 | 839,860 |
| Aktive afatgjata jo materiale | 10 | 562,846 | 512,875 |
| Investime të mbajtura deri në maturim | 11 | 30,000,000 | 30,000,000 |
| **Totali i aktiveve** | | **35,849,716** | **37,072,629** |
| **Detyrimet** | | | |
| Të pagueshme tregtare dhe të tjera | 12 | 2,337,659 | 4,049,133 |
| **Totali i detyrimeve** | | **2,337,659** | **4,049,133** |
| **Kapitali** | | | |
| Kapitali i paguar | 13 | 69,000,000 | 69,000,000 |
| Humbje të mbartura | | (35,976,504) | (32,930,622) |
| Humbje neto e periudhës | | 488,561 | (3,045,882) |
| **Totali i kapitalit** | | **33,512,057** | **33,023,496** |
| **Totali i detyrimeve dhe kapitalit** | | **35,849,716** | **37,072,629** |

Pasqyrat financiare u aprovuan nga Këshilli i Administrimit i Shoqërisë Administruese "Albsig Invest Sh.a", më 28 mars 2025 dhe u firmosën nga:

**Z. Irfan LAMI**
Drejtor Finance
Albsig Sh.a

**Z. Elton KORBI**
Administratori i Përgjithshëm
Albsig Invest Sh.a

Shënimet shpjeguese në faqet 5-23 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

## 8.2. PASQYRA E FITIM OSE HUMBJEVE DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE

**ALBSIG INVEST SHA**
**Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Pasqyra e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

| | Shënime | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 |
|---|---|---|---|
| Të ardhura nga tarifa e administrimit | 14 | 20,232,952 | 13,298,318 |
| Të ardhura të tjera | 15 | 3,200,002 | 5,875,270 |
| **Totali i të ardhurave** | | **23,432,954** | **19,173,588** |
| | | | |
| **Shpenzimet** | | | |
| Shpenzime për personelin | 16 | 19,505,185 | 18,715,882 |
| Shpenzime amortizimi | 10 | 637,079 | 1,878,500 |
| Shpenzime administrative | 17 | 4,230,021 | 3,478,373 |
| Shpenzime financiare/(të ardhura), neto | 18 | (1,427,892) | (1,853,285) |
| **Totali i shpenzimeve** | | **22,944,393** | **22,219,470** |
| | | | |
| **Humbja përpara tatimit** | | **488,561** | **(3,045,882)** |
| | | | |
| Tatimi mbi fitimin | 19 | - | - |
| **Humbja e periudhës** | | **488,561** | **(3,045,882)** |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse | | - | - |
| **Totali i humbjes gjithëpërfshirëse për vitin** | | **488,561** | **(3,045,882)** |

Shënimet shpjeguese në faqet 5-23 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

## 8.3. PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

**ALBSIG INVEST SHA**
**Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Pasqyra e flukseve të parasë për periudhën që mbyllet më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

| | Shënime | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 |
|---|---|---|---|
| **Fluksi i parasë nga aktiviteti operacional** | | | |
| **Humbja e periudhës** | | **488,561** | **(3,045,882)** |
| *Rregullime për:* | | | |
| Shpenzime amortizimi | 10 | 637,079 | 1,878,500 |
| **Fluksi i parasë nga aktiviteti operacional përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues** | | **1,125,640** | **(1,167,382)** |
| *Rregullime për kapitalin qarkullues:* | | | |
| Rritje në të arkëtueshme nga fondet | 7, 8 | 2,580,297 | 619,952 |
| (Rritje)/ pakësim në shpenzime të parapaguara | 9 | 166,200 | - |
| Rritje në të pagueshme dhe detyrime të tjera të tjera të pagueshme | 12 | (1,711,473) | 1,825,507 |
| **Fluksi i parasë neto nga aktiviteti operacional** | | **2,160,664** | **1,278,077** |
| **Fluksi i parasë nga aktivitetet investuese** | | | |
| Blerja e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara neto | 10 | (687,050) | - |
| Investimet | 11 | - | - |
| **Fluksi neto i parasë i përdorur nga aktivitetet investuese** | | **(687,050)** | **-** |
| **Fluksi i parasë nga aktivitetet financuese** | | | |
| Kapitali i paguar | 13 | - | - |
| (Ripagesa)/ arkëtime nga huamarrje | | - | - |
| **Fluksi neto i parasë i përdorur nga aktivitetet financuese** | | **-** | **-** |
| **Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë** | | **1,473,614** | **1,278,077** |
| Paraja dhe ekuivalentë në fillim të vitit | | 1,367,911 | 89,834 |
| **Mjete monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit** | | **2,841,525** | **1,367,911** |

Shënimet shpjeguese në faqet 5-23 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

## 8.4. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

**ALBSIG INVEST SHA**
**Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

Pasqyra e ndryshimeve në kapital
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

| | Kapitali aksionar | Humbja e akumuluar | Totali |
|---|---|---|---|
| **Gjendja më 31 dhjetor 2022** | **69,000,000** | **(32,930,622)** | **36,069,378** |
| Rritje kapitali | - | - | - |
| Humbja e periudhës | - | (3,045,882) | (3,045,882) |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2023** | **69,000,000** | **(35,976,504)** | **33,023,496** |
| Rritje kapitali | - | - | - |
| Humbja e periudhës | - | 488,561 | 488,561 |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2024** | **69,000,000** | **(35,487,943)** | **33,512,057** |

Shënimet shpjeguese në faqet 5-23 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare.

## 9. ALBSIG STANDARD

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR
PASQYRA E FITIM OSE HUMBJEVE DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË AKTIVET NETO

## 9.1. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

Për Drejtimin e Fondit të Investimit ALBSIG STANDARD dhe Shoqërinë Administruese të Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive Albsig Invest sh.a.

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Investimit ALBSIG STANDARD ("Fondi"), që përfshijnë pasqyrën e të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2024, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit më 31 dhjetor 2024, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Fondi në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilisteve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Çështje tjetër

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 janë audituar një auditues tjetër i cili ka shprehur një opinion pa rezerva mbi ato pasqyra financiare në 29 mars 2024.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Fondin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

### Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Fondi të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

